



Të mos ndërprehet thirrja "Zbatimi I Masave Të Eficiencës së Energjisë për Shtëpitë Individuale të Banimit"

Prishtinë, 2 shtator, 2024

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) po ndjek me shqetësim ndërprerjen e parakohshme të thirrjes publike për "Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë për shtëpitë individuale të banimit". Ky program, që ka térhequr një interesim të jashtëzakonshëm me 1,333 aplikime në vlerë prej 4,998,871.79€, është mbyllur vetëm pas tre ditësh aplikimi.

INDEP beson se kërkesa për masat e eficiencës së energjisë duhet të jetë inkurajuese, jo kufizuese. Përgjigjja masive e qytetarëve për të marrë pjesë në këtë program është shenjë që duhet të shtyjë Qeverinë e Kosovës të rrisë buxhetin e ndarë për këtë qëllim, dhe të paktën të dyfishtojë fondet e parapara. Në vitin 2020 përmes punimit "Përfitimi nga eficiencia e energjisë nga sektori rezidencial" ne argumentuam se si një politikë e tillë kishte potencial rritës eksponencial dhe sa më shumë që investohet aq më i madh dhe më i shpejtë përfitimi.

FKEE, si një institucion publik, u krijuar me qëllim që të ndihmojë vendin në arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë. Mbyllja e thirrjes për aplikime dërgon një sinjal negativ për angazhimin e qeverisë për këto qëllime. Strategjia e energjisë përcakton objektivin kumulativ prej 266.4 ktoe në kursimet e energjisë në sektorin e ndërtesave deri në vitin 2031, që përkthehet në një objektiv vjetor prej 4.44 ktoe nga viti 2024 deri në 2031. Për të arritur këtë objektiv vjetor, vlerësohet se rrëth 20 milionë euro duhet të investohen çdo vit. Prandaj, inkurajohet qeveria të ndajë fonde shtesë vjetore për FKEE-në në mënyrë që të mos rrezikohet arrija e qëllimeve të detyrueshme, sipas kërkësave të sekretariatit të komunitetit të energjisë.

Ne këshillojmë që FKEE të mos mbylli thirrjen, pavarësisht buxhetit të kufizuar. Operimi sipas parimit "Kush aplikon i pari, sherbehet i pari" nuk rrezikon funksionimin e programit, por përkundrazi lejon që edhe aplikanti i fundit të aplikojë për masa në EE. Kjo qasje mundëson që FKEE dhe Qeveria të analizojnë saktësisht koston e vlerësuar për përkrahjen e të gjithë aplikantëve, duke siguruar që programi të mbetet efektiv dhe gjithëpërfshirës.

Qeveria e Kosovës është në pozicion shumë të mirë që të përdorë këtë vullnet të qytetarëve për të investuar në mënyrë që masat e izolimit të shtrihen tek të gjithë ata. INDEP që nga viti 2012 ka theksuar moton se "investimi në eficiencë është fitim". Sot, më shumë se kurrë Qeveria duhet të shkojë një hap më tej për shtrirë investimet gjithandje Kosovës.

Që nga viti 2012, INDEP ka avokuar me moton "investimi në eficiencë është fitim". Në këto kohë sfiduese, dhe me afrimin e muajve të vjeshtës dhe dimrit, Qeveria duhet të tregojë ambicie më të

mëdha në mbështetjen e iniciativave që synojnë uljen e intensitetit energjetik të vendit dhe përmirësimin e jetesës së qytetarëve.

Ne gjithashtu konsiderojmë që mbyllja e mundësisë për aplikim ende pa u vlerësuar arsyeshmëria e projekteve të paraqitura është dekurajuese për qytetarët. Qeveria ka mjetet, ka mundësitë dhe ka bazën ligjore dhe të politikave publike që në bashkëpunim me Fondin të shtoj buxhetin dhe për të mos ndalë skemën ende pa marrë formë!

Ky program dhe këto nisma janë historike për faktin që po shënojnë një pikë kthese edhe në rritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe pjesëmarrjes së tyre të drejtëpërdrejtë në investime. Kur qytetarët po tregojnë vullnet për të ndarë gjithçka nga kursimet e familjes për eficiencë, edhe Qeveria e Fondi duhet të ndajnë diçka nga buxheti i investimeve që transformimi të jetë kuptimplotë dhe gjithpërfshirës!